



GJYKATA KUSHTETUESE KA VENDOSUR MASË TË PËRKOJSHME NDAJ DEKRETIT
TË PRESIDENTES VJOSA OSMANI PËR SHPËRNDARJEN E KUVENDIT


NJOHËSIT E ÇËSHTJEVE JURIDIKE KUSHTETUESE: DREJTËSIA KUSHTETUESE DUHET TË VIJË BRENDA DITËSH, JO JAVËSH



Gjykata Kushtetuese ka vendosur masë të përkohshme deri më 31 mars ndaj dekretit të presidentes Vjosa Osmani për shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës. Kushtetuesja ka njoftuar se vendimi ia ndalon çdo veprim presidentes Osmani në lidhje me dekretin e 6 marsit si dhe ia ndalon çdo veprim Kuvendit të Kosovës derisa masa e përkohshme është në fuqi. Ndërkaq

njohtësit e çështjeve juridike-kushtetuese vlerësojnë se drejtësia kushtetuese duhet të vijë brenda ditësh, jo javësh. E Naim Jakaj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi tha se vendimi i Kushtetueses, në planin praktik, ka pasojë të konsiderueshme për funksionimin e institucioneve, pasi gjatë kohës së kësaj mase nuk mund të zhvillohet asnjë aktivitet parlamentar

AKTUALE



TRUMPI THOTË SE FUSHATA
USHTARAKE KUNDËR IRANIT
DO TË PËRFUNDOJË
“SHUMË SHPEJT” F. 2

100 KADETË TË RINJ I SHTOHEN
SHËRBIMIT KORREKTUES TË
KOSOVËS F. 3

MINISTRI MAQEDONCI THOTË
SE OBJEKTIV I KOSOVËS ËSHTË
ANËTARËSIMI NË NATO F. 7

EKONOMI



BQK-ja DHE KËSHILLI
I EVROPËS ORGANIZUAN
PUNËTORI PËR FORCIMIN
E PRAKTIKAVE MBIKËQYRËSE
TË KRIPTO-ASETEVE F. 8

KRYETARI I AKB-së: NAFTA MBI
100 DOLLARË PËR FUÇI, ALARM
PËR EKONOMINË E KOSOVËS F. 8

SPORT



DUELE INTERESANTE NË GJYSMË-
FINALE TË KUPËS SË KOSOVËS F. 11



**‘ME VETËDIJE TË PLOTË’,
PAS KATËR MUJSH,
OSMANI E PRANON QË I
BËRI FAVOR KURTIT DUKE
I ÇAKTUAR ZGJEDHJET
MË 28 DHJETOR F. 4-5**

**KOMISIONARJA
KOS SHTYN
VIZITËN NË
KOSOVË PËR
SHKAK TË
ZHVILLIMEVE
TË FUNDIT F. 3**



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mok: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVIÇE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

TRUMPI THOTË SE FUSHATA USHTARAKE KUNDËR IRANIT DO TË PËRFUNDOJË “SHUMË SHPEJT”

WASHINGTON, 10 MARS - Presidenti amerikan Donald Trump ka thënë se operacioni ushtarak i nisur kundër Iranit muajin e kaluar do të përfundojë “shumë shpejt” dhe është zotuar se do ta godasë shtetin “shumë, shumë më ashpër” nëse i bllokun furnizimet me naftë në Lindje të Mesme. Trumpi i ka bërë këto deklarata më 9 mars, pasi Teherani ka nisur një mori raketash dhe dronësh drejt Izraelit dhe shteteve të Gjirit Arab, disa orë pas emërimit të Mojtaba Khameneit lider suprem i vendit. Ai e pason babanë e tij në këtë pozitë, Ajatollah Ali Khamenein, i cili u vra në sulmet amerikano-izraelite që nisën më 28 shkurt. “Po fitojmë bindshëm. Jemi shumë më përpara sesa kemi planifikuar”, ka thënë Trump në një konferencë për medie në Florida. “Do të përfundojë shpejt”. I pyetur nëse lufta do

të përfundojë këtë javë, ai ka sugjeruar “se me siguri që jo, por që do të ndodhë shumë, shumë shpejt”. “Nuk do të lejoj që një regjim terrorist të mbajë botën peng dhe të tentojë t’i ndalë furnizimet globale me naftë. Nëse Irani bën diçka në këtë drejtim, do të goditet shumë, shumë më ashpër”, ka thënë Trumpi. Më herët gjatë ditës Trumpi u ka thënë republikanëve në klubin e tij të golfit në Florida se sulmet ajrore ndaj Iranit ishin “një ekskursion i vogël” që “duhej bërë”. “Ne veçse kemi fituar në shumë mënyra, por nuk kemi bërë mjaftueshëm”, ka thënë ai. Trumpi ka thënë për rrjetin CBS se e ka në mendje një zëvendësim për Mojtaba Khamenein, mirëpo nuk ka përmendur ndonjë emër, sipas postimit që ka bërë në X një gazetar i CBS-it. Më herët ai u ka thënë medieve se “nuk është i



lumtur” me vendimin e Iranit që Khamenei të ngjitet në krye të shtetit dhe e ka quajtur vendimin “gabim të madh”. Ndërkohë, sekretari amerikan i

Shtetit, Marco Rubio, e ka akuzuar Iranin se po tenton “ta mbajë botën peng” duke nisur sulme hakmarrëse nëpër Lindje të Mesme dhe ka thënë

se operacionet ushtarake amerikane, me qëllim të kufizimit të kapaciteteve të Teheranit, janë duke përparuar sipas planeve. Si shembull për sulmet e Teheranit ndaj vendeve fqinje, NATO-ja ka thënë se e ka rrëzuar një raketë balistike në hapësirën ajrore turke për herë të dytë prej kur ka nisur lufta e Shteteve të Bashkuara dhe Izraelit ndaj Iranit. “NATO e ka rrëzuar sërish një raketë të nisur në Turqi. NATO-ja është e vendosur që t’i mbrojë aleatët ndaj secilit kërcënim”, ka thënë aleanca përmes një postimi në rrjete sociale më 9 mars, por pa dhënë më shumë hollësi. Ministria turke e Mbrojtjes e ka konfirmuar incidentin, duke shtuar se disa fragmente municionesh kanë rënë në toka të zbrazëta në Gaziantep, qytet në jug të Turqisë, afër kufirit me Sirinë. Nuk ka raportime për viktima.

IRANI 240 ORË PA INTERNET, NJË NGA NDËRPRERJET QE VERITARE MË TË GJATA NË BOTË

Netblocks e ka përshkruar ndërprerjen 240-orëshe të internetit në Iran si një nga ndërprerjet më të rënda të internetit në të gjithë vendin, të udhëhequra nga qeveria, të regjistruara ndonjëherë në të gjithë botën dhe e dyta më e gjata në vend që nga protestat e janarit. Sipas shërbimit të monitorimit të internetit, Irani “ka kaluar një të tretën e vitit 2026 jashtë linje”. Kujtohet se në janar Teherani vazhdoi me një fazë shtypjeje digjitale, duke u përpjekur t’i shkëpusë protestuesit nga rrjeti Starlink, i cili ishte bërë dritarja e fundit e komunikimit me botën e jashtme pas ndërprerjes së përgjithshme të internetit nga shteti. Sipas raporteve nga aktivistët dhe vëzhguesit teknikë, regjimi aktivizoi sisteme ndërhyrjeje që degraduan në mënyrë



drastike funksionimin e lidhjeve satelitore, duke rezultuar në shkëputje, humbje të mëdha të të dhënave dhe pamundësi praktike për ta përdorur rrjetin në shumë zona të vendit. Irani ka shumë vjet përvojë në kontrollin dhe manipulimin e spektrit elektromagnetik. Nga bllokimi i transmetimeve

televizive satelitore të huaja deri te ndërprerja sistematike e rrjeteve mobile dhe fikse, ai ka zhvilluar një infrastrukturë që i lejon shtetit ta “shtërënojë rubinetin” e informacionit kur konsiderohet politikisht e nevojshme. Megjithatë Starlink mbështetet në satelitë me orbitë të ulët, antena drejtuese

dhe lidhje të koduara, ai nuk funksionon në një vakum pushteti. Ndërhyrja e qeverisë nuk kishte për qëllim të “rrëzonte” të gjithë sistemin, por ta bënte atë të pabesueshëm në nivel lokal. Me ndërhyrje me fuqi të lartë në zona specifike gjeografike, lidhja bëhet e paqëndrueshme, ndërpritet shpesh dhe në fund të fundit dekurajon përdorimin e saj nga qytetarët që kanë nevojë për një sinjal të qëndrueshëm për transmetimin e videos dhe informacionit. Ekspertët e rrjetit kanë dokumentuar se ndërhyrja duket se vjen nga teknologjia e specializuar ushtarake e bllokimit, e cila është e përhapur në shumë zona të vendit. Niveli i ndërprerjes në lidhjet satelitore fillimisht u raportua të ishte rreth 30 % humbje

paketash dhe në disa zona deri në 80 %, duke treguar ndërhyrje të fortë. Analistët e krahasonjë këtë strategji me bllokimin e sinjalit GPS dhe satelitor që është përdorur në konflikte të tjera (p.sh. në Ukrainë), por që tani po vepron brenda një vendi për të shtypur protestuesit. Ndryshe nga ndërprerjet klasike të internetit, ku një mbyllje e ofruesve nga qeveria është e mjaftueshme, lidhja satelitore kërkon një përpjekje të vazhdueshme teknologjike për të ndërprerë. Pikërisht këtu po investon shteti iranian: jo në bllokadë të plotë, por në një përkeqësim të vazhdueshëm të cilësisë. Logjika është e thjeshtë, nëse komunikimi është i ngadaltë, i pasigurt dhe i pasigurt, ai pushon së funksionuari si një mjet për mobilizim masiv.

Lufta në Lindjen e Mesme, EasyJet “ngrin” rifillimin e fluturimeve për në Tel Aviv deri në dimër

Linja ajrore britanike me kosto të ulët EasyJet ka njoftuar se nuk do t’i rifillojë fluturimet për në dhe nga Aeroporti Ben Gurion i Tel Avivit të paktën deri në dimër, pasi konflikti ushtarak me Iranin vazhdon. Linja ajrore duhej ta rifillonte itinerarin e saj për në Tel Aviv më

29 mars, pas vonesave të përsëritura në rifillimin e fluturimeve të saj. Megjithatë, vendosi ta shtyjë datën përsëri, duke marrë parasysh zhvillimet në rajon. “Ne kemi marrë vendimin për të mos operuar fluturime për në dhe nga Tel Aviv këtë verë, si pjesë e një rishikimi

të vazhdueshëm të orarit tonë të fluturimeve”, tha EasyJet në një deklaratë me email. Kompania shtoi se “po e monitorojmë nga afër situatën me qëllim rifillimin e fluturimeve në dimër”. Në të njëjtën kohë, EasyJet vëren se të gjithë pasagjerët që kishin rezervuar tashmë udhëtime u

informuan me kohë dhe u ofruan mundësi alternative. “Të gjithë klientët e prekur nga vendimi janë njoftuar paraprakisht dhe u janë dhënë mundësitë e tyre të disponueshme, të cilat përfshijnë një rimbursim të plotë ose një fluturim alternativ”, thotë kompania.



Osmani thekson përkushtimin e Kosovës për ta thelluar bashkëpunimin me Britaninë

PRISHTINË, 10 MARS - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves. Ata diskutuan për zhvillimet e fundit politike në vend. Presidentja shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme

të Mbretërisë së Bashkuar për Kosovën dhe popullin tonë. Gjithashtu, ajo theksoi përkushtimin e vazhdueshëm të Republikës së Kosovës për të thelluar bashkëpunimin me Mbretërinë e Bashkuar dhe për të hapur kapituj të rinj të partneritetit që kontribuojnë në arritjen e objektivave të përbashkëta.

Gjatë bisedës u theksua edhe rëndësia e ruajtjes së një mjedisi demokratik, ku respektohen mendimet e ndryshme dhe debati publik zhvillohet në mënyrë të përgjegjshme. Në këtë kontekst u theksua se gjuha kërcënuese dhe bullizuese është e papranueshme dhe nuk duhet të ketë vend në diskursin publik.



100 KADETË TË RINJ I SHTOHEN SHËRBBIMIT KORREKTUES TË KOSOVËS

PRISHTINË, 10 MARS - 100 kadetë të rinj korrektues e gardianë i janë shtuar Shërbimit Korrektues të Kosovës, ka njoftuar ministri i Drejtësisë, Donika Gërvalla, e cila tha se Shërbimi Korrektues i Kosovës është një hallkë thelbësore e sistemit të drejtësisë, që garanton zbatimin e ligjit dhe trajtimin me dinjitet të personave të privuar nga liria. “Përmes këtij institucioni, drejtësia nuk përfundon me vendimin e gjykatës, por vazhdon me zbatimin e ligjit në praktikë, duke siguruar rend, përgjegjësi dhe respekt për dinjitetin njerëzor të çdo personi, si parime themelore bazë. Që sot, këtij shërbimi i shtohen edhe 100 kadetë të rinj korrektues, të cilët sjellin energji të re dhe përgjegjësi të madhe në një profesion që kërkon disiplinë, integritet dhe vetëkontroll çdo ditë. Ata do të jenë në vijën e parë të



garantimit të sigurisë në institucionet korrektuese dhe të zbatimit të ligjit. Roli i tyre shkon përtej ruajtjes së rendit. Çdo ditë ata do të përballen me njerëz që kanë bërë gabime dhe

që po përballen me pasojat e tyre. Profesionalizmi, korrektësia dhe mënyra se si zbatohet ligji në këto institucione ndikojnë drejtpërdrejt në mundësinë që

ata persona një ditë të rikthehen në shoqëri si qytetarë më të përgjegjshëm të këtij vendi”, ka thënë Gërvalla. Ajo ka bërë me dije se në muajt në vijim kadetët e rinj do të

ndjekin një trajnim gjashtëmuor profesional në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike. “Ky program i specializuar do t’i pajisë ata me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për përballimin e sfidave të përditshme të këtij profesioni, dhe për përgjegjësinë që bart shërbimi në institucionet korrektuese”, është shprehur ajo. Ministri i Drejtësisë ka thënë se Republika e Kosovës në vazhdimësi ka bërë hapa të rëndësishëm në këtë drejtim, gjë që dëshmohet edhe në raportet dhe vlerësimet e Këshillit të Evropës dhe mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë që monitorojnë trajtimin e personave të privuar nga liria dhe, sipas saj, ky përparim do të vazhdojë përmes forcimit të mëtejshëm të institucioneve që garantojnë zbatimin e ligjit dhe funksionimin e drejtësisë.

KOMISIONARJA KOS SHTYN VIZITËN NË KOSOVË PËR SHKAK TË ZHVILLIMEVE TË FUNDIT

PRISHTINË, 10 MARS - Komisionarja për Zgjerim e Bashkimit Evropian, Marta Kos, e ka shtyrë vizitën e planifikuar në Kosovë, kanë konfirmuar zyrtarët e Komisionit Evropian. Si arsye janë përmendur zhvillimet e fundit politike në vend. “Gjatë një bisede telefonike me kryeministrin Albin Kurti, komisionarja Kos i tha atij se do ta shtyjë udhëtimin e planifikuar në Kosovë për shkak të zhvillimeve të fundit politike”, ka bërë me dije zyra për medie e Komisionit Evropian. Sipas saj, Kos synon të udhëtojë në Prishtinë “në



momentin e parë të mundshëm”. Vizita e zyrtare evropiane

ishite bërë me dije javën e kaluar. Jozyrtareshit dihej se ajo do ta vizitonte Kosovën më 12

mars dhe kjo do të ishte vizita e saj e parë në Kosovë në cilësinë e komisionares së zgjerimit. Kosova është vendi i vetëm që Kos nuk e ka vizituar ende - e që është në zonën e fushëveprimit të saj - edhe pse e drejton Departamentin e Zgjerimit në Komisionin Evropian që nga dhjetori i vitit 2024. Në vitin 2025 si mungesë për vizitë ishte përmendur fakti që nuk ekzistonte një bashkëbisedues për shkak të krizës institucionale në Kosovë. Lajmi për shtyrjen e vizitës së saj në Kosovë vjen një ditë pas

Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka vendosur masë të përkohshme ndaj dekretit të presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, për ta shpërndarë Kuvendin, meqë institucioni nuk ka arritur ta zgjedhë presidentin e ri deri më 5 mars. Lëvizja Vetëvendosje, parti në pushtet, e ka çuar rastin në Kushtetuese. Në vendimin e Gjykatës masa e përkohshme vlen deri më 31 mars dhe deri atëherë as Osmani nuk mund ta shpallë datën e zgjedhjeve dhe as Kuvendi nuk mund ta thërrasë seancën për ta vazhduar punën.

Haxhiu takon Buleshkajn, temë diskutimi puna dhe zhvillimi i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit

PRISHTINË, 10 MARS - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu, ka pritur të martën në takim drejtorin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, Yll

Buleshkajn, me të cilin ka biseduar për punën e Agjencisë dhe për raportin që ajo përgatit për Kuvendin. “Biseduam për punën e Agjencisë, raportin që

ajo përgatit për Kuvendin, si dhe për bashkëpunimin tonë në këtë drejtim. Diskutuam gjithashtu për aspektin buxhetor që do të ndikojë në zhvillimin e Agjencisë

për nevojat funksionale si dhe për projekte që e forcojnë institucionin në aspektin zhvillimor”, ka thënë Haxhiu pas takimit.





GJYKATA KUSHTETUESE KA VENDOSUR MASË TË PËRKOHSHME NDAJ DEKRETIT
TË PRESIDENTES VJOSA OSMANI PËR SHPËRNDARJEN E KUVENDIT

NJOHËSIT E ÇËSHTJEVE JURIDIKE KUSHTETÛESE: DREJTËSIA KUSHTETUESE DUHET TË VIJË BREND DITËSH, JO JAVËSH

Gjykata Kushtetuese ka vendosur masë të përkohshme deri më 31 mars ndaj dekretit të presidentes Vjosa Osmani për shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës. Kushtetuesja ka njoftuar se vendimi ia ndalon çdo veprim presidentes Osmani në lidhje me dekretin e 6 marsit si dhe ia ndalon çdo veprim Kuvendit të Kosovës derisa masa e përkohshme është në fuqi. Ndërkaq njohësit e çështjeve juridike-kushtetuese vlerësojnë se drejtësia kushtetuese duhet të vijë brenda ditësh, jo javësh. E Naim Jakaj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi tha se vendimi i Kushtetueses, në planin praktik, ka pasoja të konsiderueshme për funksionimin e institucioneve, pasi gjatë kohës së kësaj mase nuk mund të zhvillohet asnjë aktivitet parlamentar

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 10 MARS - Gjykata Kushtetuese ka vendosur masë të përkohshme deri më 31 mars ndaj dekretit të presidentes Vjosa Osmani për shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës. Kushtetuesja tha se vendimi ia ndalon çdo veprim presidentes Osmani në lidhje me dekretin e 6 marsit si dhe ia ndalon çdo veprim Kuvendit të Kosovës derisa masa e përkohshme është në fuqi. Gjykata vlerëson se masa e përkohshme “është në funksion të parandalimit të shkakut të dëmit të pariparueshëm për rendin kushtetues të Kosovës dhe funksionimin demokratik të institucioneve kyçe në Kosovë”. “Gjykata vlerëson se ndalimi i çdo vendimi dhe veprimi të mëtejshëm nga ana e institucioneve të lartcekura është në interes publik, i

domosdoshëm për ruajtjen e rendit kushtetues dhe interesin më të mirë të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të saj”, thuhet në vendimin e Gjykatës për vendosjen e masës së përkohshme. Kjo nënkupton se Osmani nuk mund të shpallë datë për zgjedhje të reja derisa masa është në fuqi, ndërsa Kuvendi nuk mund ta vazhdojë seancën për zgjedhjen e presidentit, e nisur më 5 mars. Kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dekretit për shpërndarjen e Kuvendit u dorëzua nga kryeministri i Albin Kurti në emër të qeverisë përmes postës elektronike më 7 mars, ndërsa Gjykata e regjistroi atë më 9 mars. Ndërsa vendimin për t’ia ndaluar Kuvendit të veprojë gjatë masës së përkohshme, Gjykata tha se e mori ex officio, pra sipas detyrës së saj zyrtare me vetiniciativë.

**Sejdiu: Në këtë situatë
drejtësia kushtetuese
duhet të vijë brenda
ditësh, jo javësh**

E lidhur me këtë, juristi Korab Sejdiu ka reaguar, duke thënë se për një çështje që prek drejtpërdrejt funksionimin e dy degëve të pushtetit dhe, në fakt, edhe të tretës, kjo është një kohë tmerrësisht e gjatë. Sejdiu thotë se ndërkohë që vendime serioze e presin shtetin, në një kohë kur duket që e tërë bota është në flakë, ndoshta kjo është një nga ato situata kur drejtësia kushtetuese duhet të vijë brenda ditësh, jo javësh. “Fakti që masa e përkohshme është në fuqi deri më 31 mars lë të kuptohet se vendimi meriton mund të merr javë. Për një çështje që prek drejtpërdrejt funksionimin e dy degëve të

pushtetit - dhe në fakt, edhe të tretës - kjo është një kohë tmerrësisht e gjatë. Kur ekziston ky rrezik i theksuar i një vakumi institucional, ndërkohë që vendime serioze e presin shtetin (në një kohë kur duket që e tërë bota është në flakë, ndoshta kjo është një nga ato situata kur drejtësia kushtetuese duhet të vijë brenda ditësh, jo javësh. Sepse në raste të tilla nuk kërkohet vetëm interpretim i drejtë i Kushtetutës, por edhe efikasitet në vendimmarrje”, ka shkruar ai në “Facebook”.

**Jakaj: Masa e
përkohshme bllokoi
aktivitetin parlamentar
dhe emërimet e reja**

Naim Jakaj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi tha për Radion Evropë e Lirë se

vendimi i Kushtetueses, në planin praktik, ka pasoja të konsiderueshme për funksionimin e institucioneve, pasi gjatë kohës së kësaj mase nuk mund të zhvillohet asnjë aktivitet parlamentar. “Kjo do të thotë se nuk mund të miratohen ligje, nuk mund të mblidhen komisionet parlamentare dhe nuk mund të zhvillohen procese të rëndësishme të emërimeve, siç janë proceset për përzgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese apo të anëtarit joprokuror në Këshillin Prokurorial të Kosovës etj”, shpjegoi Jakaj. Ai shtoi se ky mekanizëm synon të parandalojë veprime që mund të shkaktojnë “pasoja të pariparueshme”. Përmes këtij vendimi, sipas tij, Gjykata ka ndaluar çdo veprim të presidentes lidhur me zbatimin e dekretit, përfshirë shpalljen e datës së zgjedhjeve të

“ME VETËDIJE TË PLOTË”, PAS KATËR MUAJSH, OSMANI E PRANON QË I BËRI FAVOR KURTIT DUKE I CAKTUAR ZGJEDHJET MË 28 DHJETOR

PRISHTINË, 10 MARS - Akuza kryesore e partive opozitare për Vjosa Osmanin ka qenë se ajo si presidente në vazhdimësi ka mbajtur anën e kryeministrit dhe kreut të LV-së, Albin Kurti. Ky qëndrim opozitar ishte përforcuar edhe më shumë kur Osmani kishte vendosur ta caktonte datën 28 dhjetor 2025 për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme, pasi Kuvendi i Kosovës kishte dështuar ta zgjidhte për herë të dytë radhazi kryeministrin. Kur ishte pyetur se a e ka bërë me vetëdije të plotë, Osmani ishte ndier e ofenduar. Pas katër muajsh e ka pranuar se kjo datë ishte favor për Kurtin.

Caktimi i kësaj date kur Osmani kishte dalë para medieve më 20 nëntor ishte komentuar jashtëzakonisht shumë, meqë konsiderohej se Osmani po i bënte favor Kurtit. Përkundër këtyre akuzave, Osmani në konferencë për medie ishte munduar ta arsyetonte veten se pse kishte marrë vendim për 28 dhjetorin. Siç deklaronte ajo atëherë, shumica e partive kanë qenë për një datë të tillë. “Data 28 dhjetor është data që kam vlerësuar që është data e vetme e mundshme, sado që kjo datë paraqet deri-diku sfida”, kishte thënë Osmani.

Për Osmanin caktimin e kësaj date e kishte bërë duke qenë se ishte afati më i gjatë, e i cili do t'i mundësonte KQZ-së t'i eliminojë disa prej sfidave në organizimin e zgjedhjeve. “Tetë parti sot janë deklaruar për datën 28 dhjetor, 5 parti për datën 21 dhjetor, derisa 3 parti kanë thënë se cilado datë është në rregull. Si presidente e kam për të detyrë që të jap afatin më të gjatë e jo më të shkurtër, në mënyrë që të kemi mundësi t'i eliminojmë disa prej sfidave të

organizimit të shpejtë të zgjedhjeve”, kishte shtuar Osmani.

Përveç kësaj, gjatë pyetjeve në këtë konferencë, Osmani ishte acaruar kur një prej gazetarëve e kishte pyetur nëse e ka marrë këtë vendim për datën 28 dhjetor me vetëdije. Osmani në konferencë kishte thënë se i siguron qytetarët se një vendim të tillë e ka marrë me vetëdije të plotë. “E para, unë besoj se kjo është një pyetje ofenduese, të cilën besoj se kurrë një burri nuk do t'ia kishe bërë, sepse ti kurrë një burri nuk i thua po vepron pa vetëdije. Një pyetje të tillë ia bëni vetëm një gruajë. Dua t'i siguroj qytetarët e Republikës së Kosovës, që asnjë vendim përgjatë gjithë karrierës sime politike nuk e marrë pa vetëdije, pra e kam marrë me vetëdije të plotë, me besim të plotë që ky vendim është vetëm e vetëm në interes të Republikës së Kosovës”, kishte thënë Osmani.

Në konferencë Osmani kishte prekur edhe çështjen e mërgatës dhe diskutimin që bëhej atëherë në Kosovë se data do t'ua mundësojë atyre të vijnë në Kosovë për të votuar, meqë Lëvizja Vetëvendosje pretendonte se partitë opozitare po e kundërshtojnë pikërisht për të mos ua mundësuar mërgatës të votojnë.

Osmani atëkohë i kishte dhënë një ndihmë partisë së Kurtit, duke thënë se mërgatën duhet ta duam edhe kur vjen për të votuar e jo vetëm kur dërgon para e kur investon në Kosovë “Të gjitha partitë kanë thënë se nuk janë kundër mërgimtarëve, nuk janë kundër mërgatës. Pse ju po paragjykonit se mërgata është vetëm në favor të një partie. Këto janë zgjedhje të reja. Partitë kanë deklaruar se nuk janë kundër mërgatës dhe, siç



thashë, si presidente kam një detyrim që të zgjedh një datë kur kemi pjesëmarrje më të madhe e jo pjesëmarrje më të vogël të qytetarëve me të drejtë vote. Dhe sipas ligjit që e kanë miratuar po këto parti politike, mërgata ka të drejtë të barabartë me votë me të gjithë qytetarët që jetojnë çdo ditë në Kosovë. Kjo është e drejtë e garantuar me ligj, të cilën ua kanë dhënë të gjitha partitë shqiptare pa dallim. Pra ata kanë të drejtë të votojnë dhe në ofitë se kanë të drejtë të votojnë e janë në Kosovë në atë datë, janë më se të mirëseardhur. Kur mërgata po investon në Kosovë, kur po dërgon remitanca në vlerë të buxhetit të Republikës së Kosovës, kur po investon në biznese që po krijojnë vende të punës, të gjithë po e duam, rrjedhimisht duhet ta duam edhe kur vjen ta vizitojë familjen, edhe datën e zgjedhjeve. Unë jam presidente edhe e atyre dhe do ta mbroj të drejtën e tyre derisa të jem në politikë pavarësisht në çfarë pozicioni jam në politikë. Por ju siguroj se vendimet janë me vetëdije. Asnjëherë pa vetëdije”, kishte thënë Osmani.

Kurti e kishte mirëpritur vendimin e Osmanit për caktimin e 28 dhjetorit si datë për zgjedhje, duke e konsideruar datën më të përshtatshme. “Dita

e zgjedhjeve është festë e demokracisë. Ajo bëhet edhe më madhështore kur ka pjesëmarrje sa më të madhe të qytetarëve tanë me të drejtë vote. Në të njëjtën kohë, duhet të sigurohemi që institucionet shtetërore kanë kohën e mjaftueshme për t'i bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme që procesi zgjedhor të jetë i rregullt, i drejtë dhe demokratik. Andaj, e mirëpresim caktimin e datës 28 dhjetor nga presidentja e vendit, Vjosa Osmani-Sadriu, si datën më të përshtatshme për zgjedhjet e parakohshme që po na presin”, kishte shkruar Kurti pas caktimit të datës.

Rreth 4 muaj pas, vetë presidentja Vjosa Osmani në një intervistë të dhënë të hënën në “Syri Tv” ka konfirmuar se akuzat e opozitës drejt saj për caktimin e datës së zgjedhjeve qëndronin.

Osmani në këtë intervistë, duke folur për akuzat drejt saj që po bëhen nga kampi i Albin Kurtit pas prishjes për punën e presidentit, ka pyetur nëse kishte bërë puç kur ia kishte dhënë Vetëvendosjes 28 dhjetorin si datë të zgjedhjeve. “Ka akuza që unë dhe presidenti Begaj kemi lobuar për rrëzimin e qeverisë Kurti. Ai takim ka qenë në shtator ku ne jemi ftuar në emër të sekretarit të Thesarit, të

përfaqësuesit të Trumpit për misione speciale dhe ka qenë një person i tretë që udhëheq Bankën për Eksporte dhe Importe. E gjithë Evropa Juglindore ka qenë aty. Kemi diskutuar edhe me Kroacinë dhe kemi thënë që nëse mungojmë, mund të keqkuptohemi. Në tokën amerikane ta refuzosh pjesëmarrjen është absurde”, ka thënë ajo.

Osmani duke folur për takimin në ShBA, ka thënë se ai ka ndodhur në muajin shtator dhe ka numëruar disa prej vendimeve të saj që i konsideron në favor të qeverisë Kurti. “A ia paskam organizuar unë puçin z. Kurti duke ia dhënë datën 28 dhjetor a? Duke ia hequr masat Kosovës? Duke i sjellë njohje Kosovës ia paskam organizuar puçin? Duke i vizituar komunat e Kosovës që drejtohen nga LV ia paskam organizuar puçin? Duke pritur diasporën ia paskam organizuar puçin? Nëse të gjitha këto konsiderohen puçe, po rikthehem tek ajo që thashë më herët, kur aleatja më e fuqishme e tyre trajtohet kështu, llogaritni të tjerët. Është për keqardhje dhe secili prej nesh do të duhej t'i mbronin institucionet e jo të bëhet thirrje për pushkatim të presidentes të bazuar në gënjeshtër të pastra”, ka deklaruar Osmani. /Express/



Grenell i reagon Vjosa Osmanit: Po gënjen, bashkë me Kurtin keni qenë ekipë katastrofale

Prishtinë, 10 mars- Emisari presidencial për misione të veçanta, Richard Grenell, ka reaguar pas deklarimeve të një dite më parë të presidentes Vjosa Osmani se Administrata Trump është Administrata për pro-kosovare që kur vendi ka shpallur pavarësinë. Grenell ka thënë se “Osmani po gënjen”, duke thënë se ajo bashkë me Kurtin kanë qenë një “ekip i tmerrshëm”.

Sipas Grenell, Osmani do të thotë gjithçka për mbijetesën e saj politike. “Ajo po gënjen. Ekipi Kurti/Osmani ka qenë një katastrofë dhe të gjithë e shohim qartë këtë. Ajo do të thotë gjithçka për mbijetesën e saj politike”, ka shkruar Grenell në “X”.

parakohshme, dhe njëkohësisht ka ndaluar çdo veprim të Kuvendit për të vazhduar procedurat për zgjedhjen e presidentit të vendit.

Ndërkohë, Qeveria e Kosovës tha se mirëpriti vendimin duke thënë se ai krijon hapësirën që çështja të trajtohet në mënyrë të plotë nga Gjykata Kushtetuese. “Për tre javë jemi në gjendje pritjeje ndërkohë që një sërë marrëveshesh dhe vendimesh me rëndësi për qytetarët vazhdojnë të mbeten pa miratimin e Kuvendit”, tha Qeveria në një komunikatë. Ajo theksoi se pret që vendimi përfundimtar i Kushtetueses të japë qartësi të plotë mbi këtë çështje dhe të përcaktojë standartin kushtetues “që në të ardhmen institucionet dhe qytetarët mos të përballen me këto pengesa serioze”.

Të hënën këshilltari për media i Osmanit, Bekim Kupina, tha se

presidentja do ta “mirëpriste” masën e përkohshme, nëse gjykata do ta vlerësonte si të nevojshme caktimin e saj. “Presidenca e mirëpret atë, duke ritheksuar se masa në asnjë moment nuk paragjykon vendimin përfundimtar të Gjykatës lidhur me kushtetutshmërinë e dekretit”, tha Kupina.

Si erdhi deri këtu?

Në seancën e 5 marsit partia në pushtet i paraqiti dy kandidatë për president: Glauk Konjufcën dhe Fatmire Kollçaku-Mullhaxhën, pasi bisedimet paraprake mes Kurtit dhe dy partive kryesore opozitare, Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, për një emër konsensual, nuk kishin dhënë fryt. Seanca u ndërpre në mungesë kuorumi, pasi u

braktis nga partitë opozitare. E një ditë pas ndërprerjes së seancës më 5 mars, Osmani nxori dekretin për shpërndarjen e Kuvendit dhe e mbajti menjëherë një takim me partitë politike për të folur për datën e zgjedhjeve të parakohshme.

Në takim morën pjesë kryetarë të partive opozitare, Partisë Demokratike të Kosovës, Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, por jo edhe partia e kryeministrit Albin Kurti.

Osmani e ka arsyetuar dekretin e saj, duke thënë se 5 marsi ka qenë afati i fundit për zgjedhjen e presidentit të ri të Kosovës - meqë mandati i saj përfundon më 4 prill - por që deputetët kanë dështuar t'i përmbushin afatet ligjore.

Por, Partia në pushtet tha se dekreti i Osmanit nuk kishte bazë, meqë procedurat për

zgjedhjen e presidentit i ka nisur më 5 mars dhe ka afat prej 60 ditësh për ta finalizuar procesin, prandaj edhe u ankua në Kushtetuese.

Presidenti i Kosovës zgjidhet me dy të tretat e votave në dy raundet e para apo me 61 vota në raundin e tretë, por nevojiten 80 deputetë në sallë që seanca të mund të mbahet.

Për partitë opozitare, dy figurat e paraqitura nga partia në pushtet kanë qenë të papranueshme dhe ato kanë ngulur këmbë në marrëveshje politike ose të paraqitet një figurë konsensuale.

Vetë Osmani e synonte edhe një mandat të dytë, mirëpo emrin e saj nuk e ka propozuar askush.

Për partinë në pushtet ajo nuk i ka pasur votat e nevojshme, ndërsa për partitë e tjera ajo nuk e ka personifikuar unitetin e nevojshëm që i duhet figurës së presidentit.

ARC-ja dhe IKShPK-ja arrijnë marrëveshje bashkëpunimi

PRISHTINË, 10 MARS - Drejtori ekzekutiv i Agjencisë të Regjistrimit Civil, Jetmir Haziri dhe Ardita Baraku, drejtoreshë nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, kanë

nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi. Kjo marrëveshje mundëson verifikimin dhe plotësimin automatik të të dhënave themelore të personave, me qëllim të identifikimit të

saktë të subjektit të të dhënave dhe administrimit të procedurave përkatëse në kuadër të Sistemit të Librezave Sanitare. Përdorimi i të dhënave do të realizohet duke garantuar gjithmonë

respektimin e parimeve të ligjshmërisë, proporcion-alitetit dhe minimizimit të të dhënave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.



GJENDJA E SIGURISË NË KOMUNËN E DEÇANIT, STABILE



DEÇAN, 10 MARS - Në komunën e Deçanit është mbajtur mbledhja e parë për këtë vit e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS), e kryesuar nga kryetari i komunës, Bashkim Ramosaj. Në këtë takim morën pjesë drejtori i Shërbimeve Publike, Izet Zenuni, koordinatori i KKS-së, Gentiana Iberhysaj-Mazrekaj, përfaqësues të policisë, përfaqësues të FSK-së si dhe anëtarët e tjerë të këtij këshilli.

Kryetari Ramosaj theksoi se gjendja e sigurisë në komunën

e Deçanit është e qetë dhe stabile. Ai nënvizoi se në këtë periudhë fokusi është në organizimin e aktiviteteve për shënimin e 24 Marsit, si dhe në garën e shijatorëve që do të mbahet më 15 mars, një aktivitet me rëndësi të veçantë për qytetin tonë. Drejtori i Shërbimeve Publike, Izet Zenuni, i falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe u ndal në dy çështje të rëndësishme: vendosjen dhe mirëmbajtjen e shenjave të komunikacionit, si dhe funksionalizimin e sistemit të

kamerave të sigurisë në qytet. Përfaqësuesi i Policisë së Kosovës, Adem Çeku, theksoi se gjendja e sigurisë në komunë mbetet e qetë. Ai bëri me dije se gjatë periudhës së fundit janë regjistruar 57 raste, kryesisht të natyrës së komunikacionit, por edhe disa raste të dhunës në familje dhe vjedhjeve. Po ashtu, ai theksoi se janë shtuar masat e sigurisë në shkolla dhe në komunikacion. Në përgjithësi, gjatë takimit u vlerësua se gjendja e sigurisë në komunën e Deçanit mbetet e mirë dhe stabile.

HAPET MUZEU I SISTEMIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

PRISHTINË, 10 MARS - Është bërë përirimi i Muzeut të Sistemit Gjyqësor të Kosovës, një hap i rëndësishëm drejt dokumentimit dhe promovimit të historisë dhe zhvillimit të gjyqësorit në vend. Ky muze synon ta ruajë dhe paraqesë trashëgiminë institucionale të sistemit gjyqësor, duke ofruar për publikun dokumente, materiale dhe dëshmi të rëndësishme që pasqyrojnë rrugëtimin dhe transformimin e drejtësisë në Kosovë ndër vite. Me këtë rast, kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Albert Zogaj, theksoi rëndësinë e këtij muzeu për ruajtjen e

kujtesës institucionale të drejtësisë në vend. Nga ana tjetër, kryetari i Gjykatës Supreme, Fejzullah Rexhepi, theksoi se hapja e Muzeut të Sistemit Gjyqësor përbën një hap të rëndësishëm për ruajtjen e historisë dhe kujtesës institucionale të drejtësisë në Kosovë. Muzeu do të shërbejë si një hapësirë edukative dhe informuese për qytetarët, studentët dhe studiuesit, duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe ndërgjegjësimit për rolin dhe rëndësinë e gjyqësorit në shoqëri.



PALLATI I RINISË APLIKON TARIFA TË REJA PËR QIRAMARRËSIT E LOKALEVE NGA 1 PRILLI

PRISHTINË, 10 MARS - Ndërmarrja Publike Lokale “Pallati i Rinisë” Sh. A. ka njoftuar qiramarrësit se nga data 1 prill 2026 do të hyjë në fuqi rregullorja e re për procedurën e dhënies me qira të hapësirave të NPL “Pallati i Rinisë” Sh. A. “Rregullorja e re vjen pas një procesi të vlerësimit të qirave i realizuar dhe vlerësuar nga ekspert të licencuar të fushës, duke përcaktuar çmimin dhe metrat

e secilës hapësirë të N.P.L ‘Pallati i Rinisë’ Sh.A. Pallati i Rinisë mbetet i përkushtuar për të vazhduar bashkëpunimin me bizneset, me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve dhe krijimin e kushteve sa më të mira për zhvillimin e aktiviteteve të rëndësishme që ndikojnë në imazhin kulturor të kryeqytetit”, ka njoftuar NPL “Pallati i Rinisë”, Sh. A.



NDAHEN PAJISJE BUJQËSORE PËR 31 GRA FERMERE NGA KOMUNA E SKENDERAJT

SKENDERAJ, 10 MARS - Të martën është bërë shpërndarja e pajisjeve bujqësore për 31 gra fermere nga komuna e Skenderajt në kuadër të projektit të realizuar në bashkëpunim me FAO-n dhe UN Women.

Kryetari i Skenderajt, Sami Lushtaku, ka thënë se ky projekt është një hap i rëndësishëm drejt fuqizimit ekonomik të grave dhe mbështetjes së tyre në zhvillimin e bujqësisë dhe



ekonomisë familjare. “Gratë janë një shtyllë e rëndësishme e zhvillimit të shoqërisë dhe përkushtimi i tyre në punë e në familje meriton mbështetje të vazhdueshme. Gjatë këtij mandati do të vazhdojmë të krijojmë mundësi dhe programe konkrete për fuqizimin e grave në fusha të ndryshme, duke i mbështetur ato që të jenë pjesë aktive e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të komunës sonë!”, ka thënë Lushtaku.

Rama: Së shpejti në kryeqytet do të realizohet një mozaik kushtuar Nënë Terezës

PRISHTINË, 10 MARS - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se së shpejti në kryeqytet do të realizohet një mozaik kushtuar Nënë Terezës, një vepër artistike

nga Don Dominik Kukeli, drejtor i Qendrës Social-Edukative Don Bosko. “Sot në Don Bosko pata mundësinë ta shoh nga afër këtë qendër dhe punën e

jashtëzakonshme që bëhet me të rinjtë. Vizitua edhe hapësirat mësimore, laboratorët dhe programet profesionale të kësaj qendre që prej vitesh formon breza

të rinj me dije dhe vlera. Kryeqyteti do ta mbështesë projektet që i shtojnë qytetit një hapësirë me vlerë artistike dhe shpirtërore”, ka thënë Rama.



Ushtarët e Zvicrës do të qëndrojnë në Kosovë deri në vitin 2029

PRISHTINË, 10 MARS - Dhoma e Lartë e Parlamentit të Zvicrës dëshiron ta zgjasë praninë e trupave zvicerane në Kosovë deri në vitin 2029. Të martën ajo miratoi një vendim përkatës me 37 vota për, 2 kundër dhe 4 abstenime, ka njoftuar gazetari Enver Robelli, referuar medieve zvicerane.

Që nga tetori i vitit 1999 ushtria zvicerane merr pjesë në misionin ndërkombëtar

paqeruajtës të NATO-s në Kosovë (KFOR) me kontingjentin e saj të quajtur Swisscoy. Aktualisht numri maksimal i pjesëtarëve të ushtrisë zvicerane është 215, ndërsa mandati i tanishëm përfundon në fund të vitit 2026. Qeveria e Zvicrës u ka kërkuar dy dhomave të parlamentit federal që ta zgjasin mandatin deri në fund të vitit 2029, duke e mbajtur numrin e trupave të

pandryshuar. Megjithatë, qeveria kërkon t'i jepen kompetenca për ta rritur numrin e personelit deri në tridhjetë persona, në rast se situata e sigurisë përkeqësohet dhe KFOR-i kërkon përf forcime. Ministri i Mbrojtjes, Martin Pfister, deklaroi se aktualisht gjendja është e qetë, por ajo mbetet e paqëndrueshme, veçanërisht në veri të Kosovës, ku tensionet mes etnive

vazhdojnë.

Në vitin 2023 incidentet e rënda të sigurisë e shtynë NATO-n që ta përforconte KFOR-in dy herë. NATO dhe vendet pjesëmarrëse janë të mendimit se KFOR-i duhet të qëndrojë derisa marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë të normalizohen.

Sipas ligjit, angazhimi i Swisscoy duhet të miratohet nga parlamenti.

Pas Dhomës së Lartë



(Ständerat), radha i kalon Dhomës së Ulët (Nationalrat). Buxheti për 215 pjesëtarë të ushtrisë kap vlerën prej 48,9 milionë frangash.

EES-i NË ZONËN SHENGEN, SVEÇLA NË FORUMIN E SALZBURGUT: TË INTERESUAR TË PËRFITOJMË NGA SISTEMET QË RRISIN SIGURINË KUFITARE

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 MARS - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka marrë pjesë në takimin e Forumit të Salzburgut, ku është diskutuar për bashkëpunimin rajonal në fushën e menaxhimit të migracionit dhe sigurisë kufitare.

Gjatë fjalës së tij ministri Sveçla mirëpriti lansimin e Sistemit të Hyrje/Daljes (Entry/Exit System - EES), duke e cilësuar hap të rëndësishëm drejt modernizimit dhe digjitalizimit të kufijve të jashtëm të zonës Schengen.

Ai theksoi se Kosova është e interesuar të përfitojë nga sisteme të tilla për ta rritur sigurinë kufitare dhe për ta përmirësuar menaxhimin e migracionit.



Ministri theksoi rëndësinë e informimit të qytetarëve të Kosovës për rregullat e udhëtimit dhe qëndrimit në zonën Schengen, por dhe rregullat në Kosovë që janë në përputhje me direktivat e BE-së, përmes

fushatave informuese dhe platformave online të dedikuara. Siç thuhet në njoftim, në kuadër të diskutimit për bashkëpunimin me Frontex në Ballkanin Perëndimor, Sveçla vlerësoi bashkëpunimin ndërmjet Ministrisë së Punëve të

Brendshme dhe Frontex, duke theksuar angazhimin e përbashkët me Policinë e Kosovës në disa pika kufitare dhe në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.

Ministri Sveçla ritheksoi përkushtimin e Kosovës për ta thelluar bashkëpunimin me partnerët evropianë dhe avancimin e bashkëpunimit me Europol-in për të kontribuar si partner i besueshëm në sigurinë rajonale dhe më gjerë.

Në marginat e Forumit të Salzburgut që po mbahet në Hungari, Sveçla ka takuar Olivier Onidi, zëvendës drejtor i përgjithshëm i DG HOME në Komisionin Evropian.

Gjatë këtij takimi ministri Sveçla e ka njoftuar Onidin me prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me theks të veçantë në luftimin e krimit të organizuar, forcimin e sundimit të ligjit, si dhe rritjen e sigurisë së kufijve dhe të sigurisë publike në përgjithësi.

“Diskutuam gjithashtu për rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe partnerëve evropianë, përfshirë bashkëpunimin me agjencitë e Bashkimit Evropian si Frontex dhe Europol. U dakorduam që bashkëpunimi të intensifikohet edhe më tej, me qëllim të kontributit të përbashkët në forcimin e sigurisë rajonale dhe më gjerë”, ka thënë ministri Sveçla pas këtij takimi.

MINISTRI HOTI KRIJON KOMISIONIN E ANKESAVE PËR VENDIMET E INSPEKTORATIT TË PUNËS

PRISHTINË, 10 MARS - Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare ka njoftuar për themelimin e një komisioni të ri që do të merret me shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve të Inspektoratit Qendror të Punës. Sipas njoftimit të kësaj ministrie, vendimi për themelimin e Komisionit të Ankesave është marrë nga ministri Andin Hoti. “Me qëllim të adresimit të çdo ankesë ose paqartësie në raport me vendimet e Inspektoratit Qendror të Punës, sot ministri Hoti ka marrë vendim për themelimin e Komisionit të Ankesave për shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve përfundimtare të inspektimeve nga Inspektorati Qendror i Punës”, thuhet në njoftim.

Nga kjo ministri bëhet me dije se komisioni do t'i shqyrtojë ankesat që paraqiten nga qytetarët dhe palët e interesuara lidhur me vendimet e marra nga Inspektorati Qendror i Punës. Në të njëjtën kohë, Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare ka ftuar qytetarët ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre ligjore për të paraqitur ankesa brenda afateve të përcaktuara. “Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare fton të gjithë qytetarët që në përputhje me ligjin dhe me



afatet e parapara, ta shfrytëzojnë të drejtën për t'i adresuar ankesat në ministri”, thuhet në njoftimin e Ministrisë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare.

Para disa ditësh ministri Hoti pati marrë vendim për themelimin e katër komisioneve: 1. Komisioni i Ankesave për shtesat e fëmijëve dhe shtesat për lehonat; 2. Komisioni i Ankesave

për ndihmën sociale; 3. Komisioni zbatues për shqyrtimin e kërkesave nga programi pilot SAS; 4. Komisioni i Ankesave për programin pilot SAS. “Çdo qytetar që konsideron se i është cenuar e drejta, ka adresë institucionale për ta kërkuar drejtësinë. Ftoj të gjithë që ankesat dhe kërkesat t'i drejtojnë pranë komisioneve përkatëse, në mënyrë që çdo rast të trajtohet me seriozitet dhe paanshmëri. Angazhimi im mbetet i qartë: trajtim i barabartë për secilin, zbatim strikt i ligjit dhe asnjë tolerim ndaj padrejtësive”, ka shkruar Hoti në “Facebook”.

Ministri Maqedonci thotë se objektiv i Kosovës është anëtarësimi në NATO

PRISHTINË, 10 MARS - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka pritur në takim Blanca Hereza, ushtruese e detyrës e shesheve të operacioneve aktuale, Divizioni për Operacione i Shtabit të Përgjithshëm të NATO-s, ndërkaq kanë folur për zhvillimet aktuale Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës si dhe planet për të ardhmen.

Maqedonci në rrjetet sociale ka shkruar se objektiv i Kosovës është anëtarësimi në NATO. “Ishte kënaqësi dhe nder i veçantë të pres në takim znj. Blanca Hereza U.D- Shëfën e operacioneve aktuale, Divizioni për Operacione i Shtabit të

Përgjithshëm të NATO-s. Me këtë rast, znj. Hereza e njoftova me zhvillimet aktuale në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, si dhe planet për të ardhmen. Nën vizova që vazhdojmë me përkushtim të koordinohemi e të bashkëpunojmë ngushtë me KFOR dhe Ekipin Këshillues

dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT), ndërsa ritheksova se objektiv i ynë është anëtarësimi në NATO, në mënyrë që vendi ynë dhe FSK të vazhdojë edhe më fuqishëm të jap kontribut në ruajtjen e stabilitetit dhe paqes, e për këtë po angazhohemi çdo ditë”, ka shkruar ai në “Facebook”.



Kryetari i AKB-së: Nafta mbi 100 dollarë për fuçi, alarm për ekonominë e Kosovës

PRISHTINË, 10 MARS - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, ka shprehur shqetësimin për rritjen e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare, e cila ka kaluar mbi 100 dollarë për fuçi, nivelin më të lartë që nga viti 2022. Ai ka thënë se kjo rritje po godet drejtpërdrejt transportin,

industrinë dhe konsumatorët në Kosovë, duke rritur kostot e prodhimit, shërbimeve dhe çmimet në treg. “Nëse kjo situatë vazhdon, pritjet presion i ri inflacionist dhe rritje e mëtejshme e çmimeve në vend. AKB-ja kërkon nga institucionet e Kosovës monitorim dhe mbështetje të tregut të

derivateve, transparencë më të madhe në formimin e çmimeve tavan nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, kurse bizneset që merren me derivate furnizim të rregullt të tregut vendor. Njëkohësisht, vlerësojmë se është e domosdoshme që shteti të rrisë vlerën sasiore të rezervave

strategjike të derivateve, në mënyrë që vendi të jetë më i përgatitur për përballimin e krizave energjetike dhe luhatjeve në tregjet ndërkombëtare. Stabiliteti energjetik dhe ekonomik është jetik për zhvillimin e qëndrueshëm të bizneseve dhe mirëqenien e qytetarëve”, ka thënë Shahini.



“FLUTUROJNË” ÇMIMET NË KOSOVË, INFLACIONI ARRIN 6 %

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 10 MARS - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka njoftuar se Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) ka shënuar rritje mesatare prej 6 % në muajin shkurt 2026 krahasuar me muajin shkurt të vitit 2025. Ndërkohë, inflacioni mujor në shkurt 2026, krahasuar me janarin e po këtij viti, ishte 0,6 %. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë të grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: shërbime të tjera në lidhje me pajisjet personale të transportit (42,5 %); bileta të fluturimeve



(39 %); furnizim me ujë dhe shërbime të ndryshme që kanë të bëjnë me vendbanimin (33,4 %); lëndë djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (16,8 %); pemë (16,4 %); mirëmbajtje dhe riparim të pajisjeve personale të transportit (15,1 %); mish (14,7 %); pushime të organizuara (13,2 %); shërbime ambulantore (9,6 %); shërbime hoteliere (9,5 %); kafe, çaj dhe

kakao (9,3 %); peshq (8,0 %); sheqer, reçel, mjaltë, çokolllatë dhe ëmbëlsira (7,4 %); vegla dhe pajisje për shtëpi dhe kopsht (6,7 %); kujdes personal (6,6 %); perime (6,4 %); pije alkoolike (6,4 %); mallra dhe shërbime për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (6,1 %); qumësht, djathë dhe vezë (5,6 %); mirëmbajtje dhe rregullim të vendbanimit (5,5 %); prodhime ushqimore (5,4 %); gjëra personale (5,2 %); bukë dhe drithëra (5,2 %); duhan (4,2 %); produkte mjekësore, aparaturë dhe pajisje (3,9 %); mobile dhe orendi, qilima dhe mbulesa të tjera dyshemeje (3,9 %); veshje (3,3 %); vajra dhe yndyra (3,1 %); ujë mineral, pije joalkoolike,

lëngje nga pemët dhe perimet (2,7 %); me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 6,4-përqindësh në IHÇK. Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: karburante dhe lubrifikantë për pajisjet e transportit personal (-7,6 %) me një ndikim prej -0,4-përqindësh në IHÇK. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë të grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: shërbime të tjera në lidhje me pajisjet personale të transportit (24,4 %); perime (5,8 %); pemë (4,0 %); pajisje audio-vizuele, fotografike për përpunimin e informatave (3,8 %); shërbime ambulantore (2,4 %); mish (2,4

%); shërbime hoteliere (1,9 %); sheqer, reçel, mjaltë, çokolllatë dhe ëmbëlsira (1,9 %); vegla dhe pajisje për shtëpi dhe kopsht (1,7 %); karburante dhe lubrifikantë për pajisjet e transportit personal (1,5 %); pajisje shtëpiake (1,4 %); kafe, çaj dhe kakao (1,3 %); kujdes personal (1,3 %); lëndë djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (1,2 %); bukë dhe drithëra (0,6 %) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 1,1-përqindësh në IHÇK. Ndërsa, rënie e çmimeve vërehet te grupet e COICOP-it: bileta të fluturimeve (-18,2 %); energji elektrike (-4,3 %) dhe qumësht, djathë dhe vezë (-2,8 %) me një ndikim prej -0,5-përqindësh në IHÇK.

BQK-JA DHE KËSHILLI I EVROPËS ORGANIZUAN PUNËTORI PËR FORCIMIN E PRAKTIKAVE MBIKËQYRËSE TË KRIPTO-ASETEVE

PRISHTINË, 10 MARS - Banka Qendrore e Kosovës (BQK), me mbështetjen e Këshillit të Evropës, Zyra në Prishtinë, në kuadër të Aksionit Kundër Korrupsionit dhe Krimit Ekonomik (ACEC), i cili mbështetet nga Projekti i Përbashkët i Këshillit të Evropës Kundër Krimit Ekonomik (PECK), organizuan punëtorinë katërditore për forcimin e praktikave mbikëqyrëse të sektorit të krypto-aseteve dhe për vlerësimin e kornizës ligjore ekzistuese për këtë sektor. Punëtorja u mbajt nga 3-6 mars, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të BQK-së, Njësisë së Inteligjencës Financiare të Kosovës (NjIF-K) dhe Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), si palë që kanë detyra nga Ligji për Kripto-asetet, duke treguar rëndësinë e

bashkëpunimit ndërinstitucional në rregullimin dhe mbikëqyrjen e këtij sektori në zhvillim. Punëtorinë e hapën Vlora Marmullakaj, përfaqësuese e projektit, e cila paraqiti qëllimin dhe përmbajtjen e punëtorisë, duke theksuar mbështetjen e vazhdueshme të projektit për institucionet e Kosovës në nisma kundër krimit ekonomik, përfshirë parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit, dhe tani duke përkrahur institucionet në fushën e krypto-aseteve; dhe Sokol Shasivari, drejtor i Departamentit të Tregjeve, Institucioneve Jobankare dhe Kripto-Aseteve në BQK, i cili theksoi zhvillimet në kornizën rregullative dhe mbikëqyrëse për sektorin e krypto-aseteve, rëndësinë e forcimit të



vazhdueshëm të kapaciteteve mbikëqyrëse dhe nevojën për avancimin e mëtejshëm të kornizës ligjore dhe rregullative në përputhje me standardet ndërkombëtare. Gjatë ditëve të punëtorisë u zhvilluan prezantime dhe gjetje nga ekspertët i Këshillit të Evropës, të cilat u përqendruan në praktikën ndërkombëtare të mbikëqyrjes dhe zhvillimin e mjeteve praktike

për zbatimin e një qasjeje mbikëqyrëse të bazuar në rrezik. Në ditën e parë u paraqit drafti fillestar nga BQK i Manualit të Mbikëqyrjes Prudenciale të Ofruesve të Shërbimeve të Kripto-Aseteve (OSHK), dokument kyç për zbatimin e qasjes së bazuar në rrezik. Manuali mbulon të gjithë ciklin mbikëqyrës, nga licencimi e deri te mbikëqyrja e vazhdueshme dhe marrja e masave korrigjuese, duke përcaktuar procedura të qarta. Në këtë kuadër u trajtua edhe procesi i licencimit të OSHKA-ve sipas kërkesave të rregullores përkatëse dhe procedurave të parashikuara në manual për shqyrtimin e aplikimeve. Kurse dita e dytë iu kushtua vlerësimit të Ligjit për Kripto-Asetet, me fokus në identifikimin e

mangësive të zbatimit fillestar dhe shqyrtimin e mundësive për avancimin e mëtejshëm të domosdoshmë të tij. Diskutimet u orientuan drejt harmonizimit të kornizës ligjore me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare, duke përfshirë elemente të Rregullores së BE-së për Tregjet e Kripto-Aseteve (MiCA), dhe reflektuan komente dhe rekomandime të ekspertëve ndërkombëtarë dhe grupit punues të BQK-së për Kripto-Asete. BQK-ja vlerëson mbështetjen e vazhdueshme të Këshillit të Evropës për bashkëpunimin me partnerët institucionalë dhe ndërkombëtarë për forcimin e kornizës mbikëqyrëse dhe rregullative të sektorit financiar në Republikën e Kosovës.

Më pak vizitorë në hotele në muajin janar sesa një vit më parë

PRISHTINË, 10 MARS - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e hotelierisë për muajin janar 2026. Në janar 2026 numri i vizitorëve në hotele ishte 66 980, prej tyre vizitorë vendorë ishin 27 377 dhe vizitorë të

jashtëm ishin 39 603. Krahasuar me muajin janar të vitit 2025 (sa ishin 69 227 vizitorë), pati rënie të numrit të përgjithshëm të vizitorëve në hotele për 3,2 %. Numri i net-qëndrimeve ishte 126 838, prej tyre 71 197 (56,1

%) nga vizitorët e jashtëm dhe 55 641 (ose 43,8 %) nga vizitorët e brendshëm. Numrin më të madh të vizitorëve të brendshëm në hotele e ka rajoni i Pejës me 10 868 vizitorë dhe me 32 372 net-qëndrime.

Sa iu përket vizitorëve të huaj, krahasuar me periudhën paraprake (janar 2025), pati rënie të vizitorëve për 4,4 %. Në total, 39 603 vizitorë të huaj, nga të cilët numri më i madh ishte nga: Shqipëria, Gjermania, Zvicra, Turqia etj.



NGA SUN TZU TE NAPOLEONI: STRATEGËT MË TË MËDHENJ QË KA NJOHUR NJERËZIMI

Historia e luftërave nuk është shkruar vetëm nga ushtritë më të mëdha, por nga strategët më të mëdhenj dhe nga mendjet më brilante. Në histori ka pasur ushtri të mëdha, perandori të fuqishme dhe beteja të përgjakshme. Por shpesh fati i luftërave nuk është vendosur nga numri i ushtarëve, por nga mendjet që i drejtonin ato.

Disa komandantë kanë pasur një aftësi të jashtëzakonshme për të lexuar armikun, për të shfrytëzuar terrenin dhe për të gjetur zgjidhje të papritura në momentet më kritike. Me strategji gjeniale dhe vendime të guximshme, ata arritën të fitojnë beteja që dukeshin të pamundura dhe të ndryshojnë rrjedhën e historisë.

Nga filozofi kinez që e quajti luftën një art, te gjeneralët romakë që ndërtuan një perandori dhe deri te komandantët europianë që revolucionarizuan mënyrën e të luftuarit, këta janë strategët që lanë gjurmë të pashlyeshme në historinë e njerëzimit.



Sun Tzu: mjeshtri i strategjisë dhe mashtrimit

Libri më i famshëm mbi strategjinë ushtarake i shkruar ndonjëherë, nga strategu dhe filozofi kinez Sun Tzu, "Arti i Luftës", është ende në shtyp dhe po lexohet nga planifikuesit ushtarakë mbi 2000 vjet pasi ai e shkroi atë.

"E gjithë lufta bazohet në mashtrimin," shkruante Sun Tzu, duke e parë atë si çelësin për të mposhtur një armik në fushëbetejë, përmes përdorimit të dinakërisë, strategjisë dhe adaptueshmërisë. Sun Tzu vuri theksin mbi rëndësinë e të kuptuarit të mendjes së kundërshtarit, duke shfrytëzuar dobësitë e tyre për të siguruar fitoren. Ai ishte një avokat i përdorimit të inteligjencës, si dhe i forcës brutale.

Sun Tzu u kërkonte gjithashtu udhëheqësve ushtarakë të



përqendroheshin në rëndësinë strategjike të pozicionimit të ushtrive, dhe sesi terreni luan një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm. Për mendjen e Sun Tzu-së, planifikimi dhe logjistika ishin çelësi i suksesit ushtarak dhe është parë herë pas here se ai ka qenë shumë i saktë, qysh kur e shkroi Artin e Luftës, në shekullin e 5-të para Krishtit.



Aleksandri i Madh: pushtuesi që ndryshoi botën

I lindur në vitin 356 para Krishtit, koha e Aleksandrit të Madh mbi tokë ishte e shkurtër, por në aq pak kohë, ai arriti të linte gjurmë si një nga strategët më të mëdhenj ushtarakë të të gjitha kohërave. Duke trashëguar mbretërinë e

Maqedonisë në moshën 20-vjeçare, në vitin 336 para Krishtit, Aleksandri filloi të zgjeronte perandorinë që kishte ndërtuar i ati, Filipi II. Gjenialiteti i tij qëndronte në aftësinë e lindur për t'u përshtatur me situatat dhe për të improvizuar në fushën e betejës. Në të gjithë Greqinë, Egjiptin, Persinë dhe Indinë, aftësia e tij si strateg, veçanërisht duke përdorur fuqinë e kombinuar të këmbësorisë, kalorësisë dhe motorëve të rrethimit, shënoi një largim nga taktikat tradicionale greke dhe e bëri atë një forcë të pandalshme.

Një lider i lindur, guximi i Aleksandrit për të luftuar në vijën e parë e bëri atë të dashur për njerëzit e tij. Kjo, e kombinuar me shkëlqimin taktik, e bëri Aleksandrin dhe ushtrinë e tij një nga forcat më të frikshme të Botës së Lashtë, siç u dëshmuar në Betejën e Gaugamelës, në vitin 331 para Krishtit, ku Aleksandri e rrethoi ushtrinë e armiqve të tij persë në një lëvizje të guximshme, që i nxorri ata krejtësisht jashtë loje, dhe e ndihmoi Aleksandrin të siguronte një fitore kyçe.

Shkëlqimi strategjik i Aleksandrit, adaptueshmëria gjatë betejës dhe besnikëria e palëkundur që frymëzoi te njerëzit e tij, e bënë një nga më të mëdhenjtë e të gjitha kohërave, në artin e strategjisë ushtarake.



Jul Cezari: gjenerali që pushtoi Galinë dhe ndryshoi përgjithmonë Romën

Pak komandantë në histori kanë bashkuar në një figurë të vetme talentin ushtarak, zgjuarsinë politike dhe ambicien e pakufishme si Jul Cezari. Në mesin e shekullit I p.e.s., ai udhëhoqi një seri fushatash të jashtëzakonshme që çuan në pushtimin e Galisë, duke zgjeruar ndjeshëm territorin dhe fuqinë e Romës. Me manovra të guximshme, disiplinë të hekurt dhe aftësi të jashtëzakonshme për të motivuar legjionet e tij, Cezari fitoi beteja që shpesh dukeshin të pamundura. Por ndikimi i tij nuk u kufizua vetëm në fushën e betejës: kalimi i Rubikonit dhe

lufta civile që pasoi ndryshuan rrjedhën e historisë romake, duke hapur rrugën për fundin e Republikës dhe lindjen e Perandorisë Romake.

Pikërisht për udhëheqjen e treguar në Luftërat Galike dhe Luftën Civile kundër ish-aleatit të tij Pompeit, Jul Cezari konsiderohet si një nga strategët ushtarakë më të shquar të historisë. Ai u tregua një komandant i fortë dhe novator, me një aftësi për të sjellë risi, si për shembull kur ndërtoi dy ura mbi lumin Rhine për të sulmuar fiset gjermane, që e kishin menduar veten të sigurt në anën lindore të lumit.

Shembulli më i spikatur i gjenialitetit ushtarak të Cezarit erdhi në Betejën e Alesias, në vitin 52 para Krishtit. Në atë që do të rezultonte të ishte akti i fundit i Luftërave Galike, ushtria e Cezarit rrethoi vendbanimin e Alesias. Cezari urdhëroi ndërtimin e dy linjave fortifikime – një për të mbajtur Galët në Alesia të rrethuar dhe një tjetër pas trupave të tij, për të mos lejuar ardhjen e përforcimeve drejt të rrethuarve. Taktika e guximshme funksionoi dhe Roma më në fund ia doli të gjunjëzonte galët.

Një gjeneral dhe politikan legjendar me një vizion të veçantë strategjik, arritjet e Cezarit në Gali dhe në Luftën Civile i dhanë një reputacion, si një nga strategët më të mëdhenj

në histori, dhe taktikat e tij novatore në fushën e betejës ende studiohen dhe admirohen, sot e kësaj dite.



Scipio Africanus: strategu që mposhti Hannibalin dhe shpëtoi Romën

Scipio Africanus konsiderohet një nga gjeneralët më të mëdhenj të Republikës Romake dhe njeriu që arriti atë që shumëkush e mendonte të pamundur: mposhtjen e gjeniut ushtarak kartagjenas Hannibal Barca. Në kulmin e Luftës së Dytë Punike, kur Roma ishte e tronditur nga disfatat e njëpasnjëshme dhe nga marshimi i Hannibalit në Itali, Scipio ndërmoi një strategji të guximshme: ai e çoi luftën në territorin e armikut, në Afrikë, duke detyruar Hannibalin të kthehej për të mbrojtur Kartagjenën. I lindur në vitin 236 para Krishtit, Scipio Africanus ishte gjenerali romak armik i Hannibalit. Pas arritjes mahnitëse të Hanibalit, për të sjellë elefantët e luftës mbi Alpe për t’u ndeshur dhe mposhtur ushtrinë romake në disa beteja në terrenin e tyre, ai

pushtoi pjesë të mëdha të Italisë, për 15 vite. Në fund, i nxitur nga gjenerali romak Fabius Maximus, ishte Scipio Africanus ai që shpiku një kundërsulm të guximshëm kundër forcave të Hanibalit në Afrikën e Veriut, sulm që solli fundin e tij. Gjenialiteti i Africanusit si strateg ishte të studionte taktikat e Hanibalit dhe më pas t’i kthente kundër tij. Mësimi që Africanus mori nga fitoret e Hannibalit ishte rëndësia e shpejtësisë, befasisë dhe forcës dërmuese. Prandaj, ai nisi një sulm ndaj Hannibalit në Betejën e Zamës në vitin 202 para Krishtit, me një forcë këmbësorie, kalorësie dhe, elefantësh, që e pushtuan gjeneralin kartagjenas dhe e mposhtën në lojën e tij. Fitorja e Africanusit ndaj Hannibalit pati një ndikim të madh në doktrinën ushtarake romake dhe emri i tij ka hyrë në histori si një strateg dhe mendimtar i shkëlqyer ushtarak.



Frederiku i Madh: mbreti strateg që e shndërroi Prusinë në fuqi europiane

Mbreti i Prusisë midis viteve 1740 dhe 1786, Frederiku i Madh ka qenë një nga strategët më të

mëdhenj ushtarakë të historisë. Me komandimin e Ushtrisë Prusiane gjatë 16 betejave të mëdha, Frederiku u tregua një mjeshtër i taktikës, duke favorizuar shpejtësinë, fleksibilitetin, përshtatshmërinë dhe mashttrimin. Siç u dëshmua në Betejën e Leuthen-it në 1757, Frederiku favorizoi ‘rendin e zhdrejtë’, të cilin e përdori me efekt shkatërrues kur u përball me një ushtri shumë më të madhe austriake. Pasi krijoi një shpërqendrim në një pjesë të fushë betejës, teksa fshehu pjesën më të madhe të ushtrisë së tij nga kundërshtarët austriakë, ai zbatoi ”rendin e zhdrejtë”, duke e fokusuar sulmin në një krah të ushtrisë austriake. Të hutuar, austriakët u mundën, dhe kështu u sigurua reputacioni i Frederikut në të gjithë Evropën si një mjeshtër i taktikës. Frederiku tregoi se ishte një strateg i frikshëm, jo vetëm në fushën e betejës. Ai shkroi gjerësisht për çështjet ushtarake, dhe “Udhëzimi për një gjeneral të ushtrisë”, i shkruar nga ai vetë, vazhdon të studiohet dhe të admirohet shumë nga takticienët ushtarakë, edhe sot e kësaj dite. Një titan në fushën e luftës dhe një mendimtar i shkëlqyer jashtë saj, Frederiku e ktheu Prusinë në një nga vendet më të fuqishme në Evropë gjatë gjithë mbretërimit të tij.

Carl von Clausewitz: teoricieni që e shpjegoi luftën si vazhdim të politikës

Carl von Clausewitz nuk ishte

thjesht një oficer prusian, por një nga mendjet më të thella që ka analizuar ndonjëherë natyrën e luftës. Ai shërbeu në ushtrinë e Prusisë gjatë epokës së luftërave napoleoneane dhe përjetoi nga afër transformimet e mëdha që solli në strategji dhe taktikë Napoleon Bonaparti. I lindur në vitin 1780, Carl von Clausewitz ishte një ushtar prusian, teoricien ushtarak dhe strateg i shquar. Libri i tij “Mbi luftën”, i shkruar pas Luftërave Napoleonike midis viteve 1816 dhe 1830, mbetet një nga gurët e themelit të strategjisë ushtarake. Në opusin e tij madhështor, Clausewitz u bazua në përvojën e tij të luftimeve, kundër forcave të Napoleon Bonapartit për pjesën dërmuese të karrierës së tij ushtarake, duke theksuar se si fitorja në luftë mund të arrihej duke patur fillimisht popullsinë në krah, dhe më pas duke përdorur peshën dhe burimet e plota të shtetit, për të mposhtur armikun. Ai gjithashtu doli me konceptin e ‘mjegullës së luftës’, që pranon pasiguritë dhe konfuzionin që krijon lufta dhe ai u kërkoi




gjeneralëve ta përfshinin edhe këtë në planifikimet që bënin. Ai theksoi gjithashtu nevojën për të qenë të kujdesshëm kur planifikoni sulme dhe për të mos i shtrirë shumë forcat që ke në dispozicion, duke e vënë theksin në ekuilibrin delikat që nevojitet, për të arritur suksesin strategjik. Libri i Clausewitz, i dha atij një reputacion të madh si strateg ushtarak dhe njohuritë e tij kanë formuar mendimet dhe veprimet e udhëheqësve ushtarakë.

Napoleon Bonaparti: gjeniu ushtarak që tronditi Evropën

Kur bëhet fjalë për strategjinë ushtarake, emri i një njeriu qëndron mbi të gjithë të tjerët – Napoleon Bonaparti. Nga varfëria e fëmijërisë e deri tek poczicioni si Perandor i Francës, ngritja e Napoleonit në majë bazohej në një dhe vetëm një gjë – gjenialitetin e tij si strateg ushtarak. bota.al





Duele interesante në gjysmëfinale të Kupës së Kosovës



PRISHTINË, 10 MARS - Të martën në zyrat e Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) është bërë tërheqja e shortit për fazën gjysmëfinale të Kupës së Kosovës. Për dallim prej fazave të tjera të kësaj gare,

gjysmëfinalja përcakton fituesin me dy ndeshje, praluhet me sistemin vajtje-ardhje. Llapi - Ferizaj dhe Ballkani - Dukagjini do të përballen në këtë fazë, me ndeshjet që do të zhvillohen muajin e

ardhshëm, ka njoftuar FFK-ja. Ndeshjet e para të fazës gjysmëfinale do të zhvillohen më 8 prill, kurse ato të kthimit pas dy javësh apo më 22 prill. Prej katër skuadrave që do të përballen në gjysmëfinale,

vetëm dy prej tyre do të avancojnë në finalen e madhe të Kupës së Kosovës. Fituesi i kësaj gare automatikisht siguron pjesëmarrjen në garat e UEFA-s, saktësisht në Ligën e Konferencës.

LAURENT XHYLANI, LOTARI I JAVËS NË SUPERLIGË

PRISHTINË, 10 MARS - Federata e Futbollit të Kosovës (FFK), në bashkëpunim me sponsorin zyrtar të Superligës, Albi Mall, vazhdon ta japin çmimin tradicional "Ylli i Javës", i cili i dedikohet futbollistit më të dalluar të javës në Superligën e futbollit të Kosovës. Për javën e njëzet e tretë të këtij edicioni,

ky çmim i është dhënë futbollistit të FC Malisheva, Laurent Xhylani, i cili ka shënuar dy gola në ndeshjen kundër FC Prishtina, e cila përfundoi me rezultat 3:0. Vlerësimi është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit. Pasi ka marrë çmimin, Xhylani

ka shprehur lumturi që është vlerësuar lojtari më i mirë i javës. "Ka qenë një ndeshje e vështirë të cilën e kemi përgatitur shumë mirë, duke i analizuar të gjitha pikat e forta dhe të dobëta të FC Prishtinës dhe në fund arritëm një fitore të rëndësishme. Në ekip kemi një atmosferë shumë të mirë,

sidomos me ardhjen e stafit të trajnerëve. Vazhdojmë ta kemi të njëjtin synim: daljen në Evropë apo titullin kampion. Jam shumë i gëzuar për këtë çmim. I falënderoj bashkëlojtarët dhe këtë çmim ia dedikoj nënës sime", ka thënë Xhylani për faqen zyrtare të FFK-së.



FENERBAHÇE SYNON TRANSFERIMIN E FISNIK ASLLANIT

STAMBOLL, 10 MARS - Klubi turk Fenerbahçe ka nisur seriozisht përgatitjet për sezonin e ardhshëm dhe një nga prioritetet kryesore mbetet përf forcimi i repartit sulmues. Drejtuesit e klubit nga Stambolli janë duke kërkuar një sulmues që kombinon forcën fizike me potencialin e madh për të ardhmen, dhe duket se kanë gjetur profilin e duhur në Bundesligë. Sipas raportimeve të medieve, në listën e dëshirave të



verdhebluve është futur sulmuesi i Kosovës, Fisnik Asllani, i cili aktualisht

aktivizohet te TSG 1899 Hoffenheim. Klubi turk është duke përgatitur një operacion të madh për afatin kalimtar veror me synimin për t'i siguruar shërbimet e 23-vjeçarit. Megjithatë, gara për Asllanin nuk pritet të jetë e lehtë. Interesim për sulmuesin e Kosovës ka shfaqur edhe gjiganti anglez Chelsea, i cili është thënë se po ndjek nga afër zhvillimin e tij gjatë këtij sezoni. Për këtë arsye drejtuesit e Fenerbahçes

synojnë të lëvizin shpejt në merkato për të fituar avantazh në këtë duel transferimesh. I lindur më 8 gusht 2002 në Berlin, Asllani është një qendërsulmues modern me gjatësi 1.91 metra. Përfaqësuesi i Kombëtares së Kosovës dallohet jo vetëm për finalizimin para portës, por edhe për lojën me shpinë nga porta dhe dominimin në zonën kundërshtare. Sulmuesi i Kosovës ka rinovuar kontratën me Hoffenheimin

deri në vitin 2029, ndërsa forma e tij këtë sezon ka tërhequr vëmendjen e shumë klubeve evropiane. Në 26 paraqitje zyrtare me ekipin gjerman, Asllani ka realizuar 9 gola dhe ka dhënë 8 asistime, duke kontribuar në 17 gola. Me një vlerë aktuale tregu rreth 30 milionë euro, Asllani shihet si një investim për të ardhmen dhe një përf forcim potencialisht shumë i rëndësishëm për sulmin e Fenerbahçes.

PRESIDENTI I FIFA-S: KEMI 500 MILIONË APLIKIME PËR 7 MILIONË BILETA NË DISPOZICION PËR KUPËN E BOTËS



ZURICH, 10 MARS - Presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, ka dhënë një përditësim mbi përgatitjet e Botërorit 2026 në ShBA, Meksikë dhe Kanada, duke theksuar një rritje të jashtëzakonshme të kërkesës për bileta. Ai ka thënë se kanë pranuar 500 milionë aplikime për 7 milionë bileta në dispozicion për Kupën e Botës. "Botërori

do të jetë fantastik, fenomenal. Nuk kemi parë kurrë një entuziazëm të tillë në ShBA, Meksikë dhe Kanada më parë. Vetëm në katër javë, kemi marrë mbi 500 milionë aplikime për bileta. Është e pabesueshme. Kemi afërsisht 7 milionë bileta të disponueshme, por 500 milionë kërkesa, kjo nuk ka ndodhur kurrë në

historinë e FIFA-s apo ndonjë organizate tjetër", ka thënë Infantino. Ai ka theksuar se 77 nga 104 ndeshjet kanë marrë tashmë mbi një milion aplikime secila, ndërsa pjesa tjetër i ndjek ngushtë. "Po mbajmë disa bileta në rezervë për shpërndarje gjatë turneut dhe ditëve finale. Çdo stadium do të jetë i mbushur,

do të jetë një festë absolute. Njerëzit dikur thoshin se futbollin nuk ishte popullor në ShBA, por gjithçka ka ndryshuar. Ky turne do të jetë një sukses. Me 48 ekipe, 104 ndeshje, në 16 qytete në tre vende... po flasim për diçka kolosale. Nuk është vetëm një turne; është një fenomen social që do të ndalë botën", ka deklaruar shefi i FIFA-s.

KB Prishtina heq dorë nga Liga ENBL

PRISHTINË, 10 MARS - KB Sigal Prishtina ka njoftuar se është tërhequr nga garat në Ligën ENBL. Klubi nga kryeqyteti ka bërë me dije se është tërhequr nga kjo ligë për shkak të obligimeve financiare të papërbushura. "Ky

vendim vjen si pasojë e obligimeve financiare dhe administrative të papërbushura ndaj Ligës ENBL, të cilat janë krijuar nga kryesia e kaluar e klubit. Përkundër përpjekjeve të drejtuesve aktualë për të gjetur

zgjidhje dhe për ta vazhduar rrugëtimin në këtë garë, këto obligime të trashëguara e kanë bërë të pamundur vazhdimin e garimit në këtë moment", ka njoftuar KB Sigal Prishtina. Në të njëjtën kohë, duke marrë

parasysh situatën sportive nëpër të cilën po kalon skuadra dhe krizën aktuale të rezultateve, klubi ka vendosur që në këtë periudhë të përqendrohet maksimalisht në garat vendore dhe në stabilizimin e ekipit.





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Ermbotelladaora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

